



DREJTUESIT



KRYETARJA

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova (Bullgari)

Kryetari i Dhomave të Specializuara të Kosovës është përgjegjës për administrimin gjyqësor të Dhomave të Specializuara dhe për funksione të tjera që i akordon Ligji. Kryetari përfaqëson Dhomat e Gjykatësve. Një nga detyrat kryesore të Kryetarit është caktimi i gjykatësve nga Regjistri i Gjykatësve ndërkombëtarë në përbërje të një paneli dhe në çështje gjyqësore para Dhomave të Specializuara. Kryetari i Dhomave të Specializuara kryen njëkohësisht detyrën e kryetarit të panelit të Gjykatës Supreme në çështjet ku merr pjesë.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare më 14 dhjetor 2016 dhe u riemërua për një mandat katërvjeçar, duke filluar nga data 15 dhjetor 2020. Për herë të parë, ajo e filloi detyrën më 12 janar 2017. Kryetare Trendafilova, e cila më parë ka shërbyer si gjykatëse në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (2006-2015), është një gjykatëse, juriste dhe akademike e shquar me përvojë të madhe në fushën e të drejtës penale ndërkombëtare, të drejtës dhe procedurës penale dhe të drejtës për të drejtat e njeriut.



ADMINISTRATORJA

Dr. Fidelma Donlon (Irlandë)

Administratori është përgjegjës për administrimin e DHSK-së dhe ZPS-së. Gjithashtu, ai është në krye të shërbimeve mbështetëse gjyqësore. Administratori është përgjegjës për funksione të nevojshme të procedurave para DHSK-së, si mbrojtja, pjesëmarrja e viktimave, paraburgimi, mbrojtja dhe mbështetja e dëshmitarëve si dhe është në krye të njësive të tjera mbështetëse, si njësia juridike, njësia për administrimin gjyqësor, njësia e shërbimeve gjuhësore, njësia e informimit dhe e komunikimit me publikun dhe administrata. Administratori gjithashtu administron subvencionin e drejtpërdrejtë të BE-së, nëpërmjet të cilit financohet buxheti i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Dr Fidelma Donlon u emërua Administratore në prill të vitit 2016 dhe u riemërua për një mandat katërvjeçar në prill të vitit 2020. Si administratore e lartë gjyqësore e sprovuar dhe akademike dhe juriste e respektuar, dr. Donlon ka shërbyer në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen, në Gjykatën për Krime të Luftës të Bosnjë-Hercegovinës dhe Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë-Hercegovinë. Që nga viti 2015, ajo gjithashtu drejtoi themelimin strategjik dhe organizativ të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

GJYKATËSIT

Gjykatësit u emëruan në Regjistër më 7 shkurt 2017 nga Autoriteti Emërues, pas rekomandimit të një paneli të pavarur përzgjedhës të Gjykatësve Ndërkombëtarë. Më 22 shtator 2020 u emëruan edhe gjashtë gjykatës të tjerë. Aktualisht ky Regjistër ka 23 gjykatës. Gjykatësit janë fizikisht të pranishëm në Dhomat e Specializuara vetëm sipas nevojës, me kërkesë të Kryetares së Dhomave të Specializuara, për ushtrimin e detyrave të caktuara.

Dhomat të cilat i përkasin dhe pasqyrojnë çdo nivel të sistemit gjyqësor të Kosovës, përbëhen prej paneleve në vijim: gjykatës individualë të cilët kryejnë detyrat e

gjykatësit të procedurës paraprake; trupa gjykues të përbërë prej tre gjykatësish (dhe një gjykatësi rezervë); panele të Gjykatës së Apelit të përbëra prej tre gjykatësish; panele të Gjykatës Supreme të përbëra prej tre gjykatësish; panele të Gjykatës Kushtetuese të përbëra prej tre gjykatësish; dhe gjykatës individual të tjerë të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të Dhomave të Specializuara.

Në përputhje me Ligjin për themelimin e Dhomave të Specializuara, gjykatësit janë të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre dhe nuk marrin e as kërkojnë udhëzime prej asnjë qeverie ose burimi tjetër.

GJYKATËSIT NDËRKOMBËTARË TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS



Gjakatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetarja (Bullgari)



Gjakatës Çarls L. Smith, III
Nënkryetari (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)



Gjakatës Vidar Stensland
Gjakata Kushtetuese (Norvegji)



Gjakatës Antonio Balsamo
Gjakata Kushtetuese (Itali)



Gjakatës Rumen Nenkov
Gjakata Kushtetuese (Bullgari)



Gjakatëse Romina Inkuti
Gjakata Kushtetuese -
Gjakatëse Rezervë (Itali)



Gjakatëse Kristinë van den Vajngart
(Belgjikë)



Gjakatëse Mishelë Pikar
(Francë)



Gjakatës Tomas Laker
(Gjermani)



Gjakatës Emilio Gati
(Itali)



Gjakatës Roland Dekers
(Holandë)



Gjakatës Mihael Bolander
(Gjermani)



Gjakatës Kai Ambos
(Gjermani)



Gjakatës Kenet Roberts
(Kanada)



Gjakatëse Mapi Feld-Folia
(Holandë)



Gjakatës Kristof Barte
(Gjermani)



Gjakatës Vladimir Mikula
(Republika Çeke)



Gjakatës Gënel Metro
(Zvicër)



Gjakatës Nikola Giju
(Francë)



Gjakatës Zhiber Biti
(Francë)



Gjakatës Daniel Fransen
(Belgjikë)



Gjakatës Fergal Gejnor
(Irlandë)



Gjakatëse Nina Jorgensen
(Norvegji)

Për informacion më të gjerë, si dhe për jetëshkrimet e të gjithë gjykatësve të Dhomave të Specializuara të Kosovës,
ju lutemi vizitoni www.scp-ks.org